

MARRËVESHJE ZBATIMI

ndërmjet

**Republikës së Shqipërisë,
të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë - Shqipëri**

- më poshtë e referuar si "MFE" -

dhe

**Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim
Ndërkombëtar (GIZ)
Dag-Hammarskjöld-Weg 1-5
65760 Eschborn**

- më poshtë i referuar si "GIZ" -

në lidhje me projektin

Këshillimi për migracionin në Shqipëri

(në kontekstin e Programit Global "Migracioni për Zhvillim"
(PME))

- më poshtë i referuar si "Projekti" -

Përmbajtja

	Faqe
Baza e Marrëveshjes	2
1. Objektivi i projektit dhe treguesit	3
2. Kontributet për Projektin nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë nëpërmjet GIZ-it	4
Sigurimi i ekspertëve	4
Furnizimi me materiale dhe pajisje	5
Kostot operative dhe administrative	5
Kontribute të tjera	5
3. Kontributet për Projektin nga Republika e Shqipërisë nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë	5
Sigurimi i ekspertëve dhe i personelit ndihmës	5
Kostot	5
Sigurimi i ambienteve, ndërtesave dhe mjediseve të punës	
Kontribute të tjera	6
4. Dispozita të tjera	6
Vlerësimi	6
Komiteti Drejtues	6
Pezullimi i kontributeve dhe përfundimi i Marrëveshjes	6
Afati i Marrëveshjes	6
Rregullimi i Marrëveshjes	7
Forma e shkruar	7
Marrëveshjet me organizatat zbatuese të veçanta	7
Marrëveshjet Qeveritare	7
Hyrja në fuqi, kopjet	7

Baza e Marrëveshjes

Sa më poshtë vijon përbën bazën e kësaj Marrëveshje:

- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunim Teknik të datës 21 tetor 1988 (shih Shtojcën 1),
- Rezultatet e Bisedimeve për Bashkëpunimin për Zhvillim ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të mbajtura në Tiranë në datën 12 korrik 2016 (shihni Procesverbalin Përmbledhës të Bisedimeve për Bashkëpunimin për Zhvillim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të mbajtura në Tiranë në datën 12 korrik 2016, Shtojca 2).

Detajet e Projektit janë parashtuar në këtë marrëveshje zbatimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ).

GIZ-i vepron në zbatim të detyrës së ngarkuar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

Për Republikën e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të jetë autoriteti përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes.

1. Objektivi i projektit dhe treguesit

Informacion paraprak për Projektin: Programi Global, "Migracioni për Zhvillim" (PME) është autorizuar nga Ministria Federale gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe po zbatohet nga Qendra për Migracion dhe Zhvillim (CIM) – veprimtari e përbashkët e *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH* Shërbimet Ndërkombëtare dhe të Specializuara të Gjetjes së Punësimit (ZAV) të Agjencisë Federale gjermane të Punësimit (Bundesagentur für Arbeit, BA).

Objektivi kryesor i programit është forcimi i kontributeve të migrantëve për zhvillimin e vendeve të tyre të origjinës dhe përmirësimin e kushteve kuadër për migracionin e ligjshëm në vendet e përzgjedhura partnere. Ky objektivi po ndiqet në mënyrë aktive në pesë fusha veprimtarie:

(1) *Këshillimi për politikën e migracionit:* kuadrot e politikës për migracionin e ligjshëm dhe kontributet zhvillimore të migracionit po përmirësohen me anë të një këshillimi të strukturuar politikash që rrit koherencën politike, kapacitetin institucional dhe bashkëpunimin, si dhe dialogun.

(2) *Këshillimi për migracionin:* po rritet mundësia e marrjes së informacionit mbi rrugët ligjore të migracionit për migrantët e mundshëm, me anë të këshillimit për migracionin; marrja e informacionit në lidhje me perspektivat e arsimimit dhe tregut të punës po rritet për migrantët e mundshëm dhe të kthyer.

(3) *Kthimi i migrantëve i orientuar nga zhvillimi:* migrantët e kthyer kontribuojnë për zhvillimin e vendeve të tyre përmes transferimit të njohurive. Po lehtësohet kthimi dhe ri-integrimi.

(4) *Bashkëpunimi me diasporën*: ndikimi zhvillimor i diasporës në vendin e tyre të origjinës po forcohet përmes bashkëpunimit me diasporën.

(5) *Ide biznesi për zhvillim*: migrantët marrin këshillim efektiv dhe kualifikohen për të zbatuar ide biznesi në vendin e tyre të origjinës.

Që prej 23 dhjetorit 2015, programi është autorizuar nga BMZ-ja për të zgjeruar veprimtaritë e tij në Republikën e Shqipërisë dhe në veçanti komponentin e saj, "Këshillim për migracionin" në bashkëpunim me MFE. Aspektet e "*Këshillimit për politikën e migracionit*" do të integrohen gjithashtu në këtë bashkëpunim.

Objektivi i komponentit të PME-së "Këshillimi për Migracionin" është lufta kundër migracionit të parregullt, duke ofruar informacion për rrugët e ligjshme të migracionit të punës dhe duke informuar për arsimin dhe formimin profesional, si dhe perspektivat e tregut të punës në Gjermani dhe në Shqipëri. Komponenti do të realizohet në Shqipëri në kuadër të Projektit të bashkëpunimit ndërmjet GIZ-it dhe MFE, për përmbajtjen e të cilit u ra dakord gjatë një seminari bashkëpunues, i cili u zhvillua në Tiranë më 23 mars 2016.

Treguesit e komponentit dhe projektit të bashkëpunimit janë:

- Sportelet e Migracionit ofrojnë këshillim për migracionin dhe punësimin në mënyrë të suksesshme
- 2000 persona këshillohen çdo vit në qendrat e këshillimit (për t'u përcaktuar përgjatë vitit të parë të zbatimit)
- 60% të 2000 personave të këshilluar personalisht shprehin se do të rekomandonin shërbimet e këshillimit të qendrave tek kërkues të tjerë shërbimesh (për t'u përcaktuar përgjatë vitit të parë të zbatimit)

GIZ dhe MFE u përkushtohen bashkërisht këtij objektivi.

2. Kontributet për Projektin nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë nëpërmjet GIZ-it

Në përputhje me Procesverbalin Përmbledhës të Bisedimeve në lidhje me Bashkëpunimin për Zhvillim ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të mbajtura në Tiranë në datën 12 korrik 2016, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë do t'i ofrojë GIZ-it deri në 1,500,000 Euro (1 milion e pesëqind mijë Euro) për kontributin gjerman. Kjo shumë do të përfshijë edhe shpenzimet e kryera nga Organizata Zbatuese Gjermane.

Kohëzgjatja e projektit sipas angazhimit të palës gjermane është deri në datën 30/11/2020.

Sigurimi i ekspertizës

GIZ-i do të vërë në dispozicion për projektin:

- deri në 4 punonjës të GIZ-it për të drejtuar dhe zbatuar projektin e bashkëpunimit, për të zbatuar detyrat e dhënies së këshillimit grupit të synuar "migrantët që kërkojnë këshillim", si dhe për të ngritur kapacitetet e personelit përkatës pranë MFE/ShKP. Një prej tyre do të jetë përgjegjës për kontributin e GIZ-it dhe do të kryejë njëkohësisht edhe funksionin e drejtuesit të ekipit të ekspertëve të vëna në

dispozicion nga Projekti për kohëzgjatjen e fazës së përshkruar në Klauzolën 4 më poshtë;

- pjesërisht duke nënkontraktuar punonjës të GIZ tek Sportelet e Migracionit (SM)/ShKP për masat e ngritjes së kapaciteteve;
- lehtësimin deri në pesë trajnime për ngritjen e kapaciteteve të Sporteleve të Migracionit të ShKP për sa i përket informimit për kanalet e migracionit për punësim, lehtësimin e shkëmbimit të përvojave (të mësuarit mes kolegësh), trajnimit të shumëfishuesve (punonjës të përzgjedhur nga ana e ShKP-së), me qëllim kualifikimin e personelit në drejtim të dhënies së këshillimit dhe shërbimeve këshillimore. Këto trajnime do të kryhen nga ana e Agjencisë Federale Gjermane të Punësimit mbi temat e mëposhtme: "Metodologjia Bazë e Këshillimit"; "Të Jetuarit dhe të Punuarit në Gjermani", "Aksesi në Tregun Gjerman të Punës";
- krijimi i një faqeje interneti, e cila përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për grupin e synuar, duke përfshirë personat e kontaktit dhe numrat e telefonit;
- hartimi i një strategjie për marrëdhëniet me publikun për Sportelet e Migracionit të ShKP-së;
- zhvillimin e kontributeve teknike dhe koordinimin e aktiviteteve, të cilët janë ende për t'u përcaktuar; lehtësimin e misionëve të ekspertëve afatshkurtër mbi aktivitetet e përmendura më sipër, si dhe çështje të mëtejshme për t'u caktuar për një periudhë deri në 100 ditë në total.
- zhvillimi i deri në 4 aktivitete për formimin e rrjeteve dhe shkëmbimin e informacioneve për grupin e synuar;
- përgatitjen e një dokumenti strategjik për (MFE)-në të politikëbërjes për migracionin e punësimit të orientuar ndaj zhvillimit
- trajnimin e punonjësve të MFE-së në lidhje me dispozitat dhe zbatimin e strategjisë

Furnizimi me materiale dhe pajisje

GIZ do të ofrojë artikujt e mëposhtëm për pajisjen e infrastrukturës teknike:

- 1 automjet për projektin;
- pajisje të teknologjisë së informacionit për zyrat pilot;
- përditësimin, faqosjen dhe printimin e informacionit për migrimin në Gjermani dhe rregullat e aksesit në tregun e punës në Gjermani për shtetasit e vendeve të treta;
- manual pune për punonjësit e Sporteleve të Migracionit me fokus në metodat e këshillimit.

Kostot operative dhe administrative

GIZ-i do të mbulojë shpenzimet operative dhe/ose administrative që shoqërohen me përmbushjen e kontributit gjerman për Projektin.

Kontribute të tjera

GIZ do të japë edhe kontributet e mëtejshme shtesë:

- Kontributet financiare dhe/ose mbështetje në konferenca, takime pune ose seminare në lidhje me çështjet e migrimit për punësim;
- Kontribute të tjera në përputhje me planin e veprimeve, ende për t'u miratuar.

3. Kontributet për Projektin nga Republika e Shqipërisë nëpërmjet MFE

Sigurimi i ekspertëve dhe i personelit ndihmës

MFE (duke përfshirë institucionet e varësisë) do të:

- emërojë deri në 4 punonjës të MFE-së, SHKP-së, Sporteleve të Migracionit për të marrë pjesë në grupin drejtues;
- emërojë të paktën 10 ekspertë homologë pranë MFE-së, SHKP-së dhe Sporteleve të Migracionit për personelin e nënkontraktuar të GIZ-it, ekspertët afatgjatë dhe afatshkurtër;
- sigurojë punonjës të nivelit drejtues dhe administrativ në Sportelet e Migracionit të cilët iu nënshtrohen masave të ngritjes së kapaciteteve;
- sigurojë pjesëmarrjen e stafit të MFE dhe institucioneve në varësi në masat e ngritjes së kapaciteteve
- MFE krijon kushtet e mjaftueshme për të garantuar pjesëmarrjen e stafit në trajnime.

Kostot

MFE do të:

- sigurojë që kostot e specifikuara në planin e veprimeve do të buxhetohen në kohën e duhur;
- marrë përsipër TVSH-në për aktivitetet e projektit, që përfitojnë institucionet respektive, dhe shpenzimet që kryhen në Shqipëri (kostot operative dhe prokurimet), si edhe për prokurimet/importet ndërkombëtare. Të sigurojë buxhet të mjaftueshëm deri në fund të projektit (11/2020). Rimbursimi i TVSH-së është i vlefshëm për të gjithë periudhën e zbatimit të projektit.
- sigurojë një buxhet për të punësuar personel të mëtejshëm pranë Sporteleve të Migracionit/ShKP-së dhe për të mbuluar të gjitha shpenzimet operative dhe për personelin në lidhje me këtë.

Sigurimi i mjediseve, ndërtesave dhe ambienteve të punës

MFE do të vërë në dispozicion të Projektit pa pagesë mjediset dhe ndërtesat e mëposhtme, duke përfshirë pajisjet dhe orëditë, duke pasur parasysh që pajisje apo orëdi të tilla nuk janë siguruar nga GIZ-i: zyrat e Sporteleve të Migracionit dhe ShKP-së në rajonet pilot dhe më tej; hyrjen në sallën e konferencave në MFE nëse është e nevojshme për aktivitete që lidhen me Projektin.

Kontribute të tjera

MFE do të

- mbështesë bashkëpunimin me njësi të tjera kombëtare dhe rajonale të MFE në zbatimin e projektit, si dhe me njësi të tjera.

4. Dispozita të tjera

Vlerësimi

GIZ mund të ndërmarrë një vlerësim të Projektit gjatë ose pas zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim, GIZ-i do të caktojë ekspertë/vlerësues të Projektit. MFE do të marrë pjesë në vlerësim. Në të gjitha rastet, do të asistojë ekspertin/ët/vlerësuesin/t në punën e tyre dhe do t'i lejojë që të shqyrtojnë të gjitha dokumentet e nevojshme.

MFE do të informohet në lidhje me rezultatet e vlerësimit nëpërmjet një raporti.

Komiteti Drejtues

GIZ dhe MFE si dhe institucionet në varësi, veçanërisht Sportelet e Migracionit/ShKP do të formojnë një Komitet Drejtues, i cili do të mbledhet minimalisht dy herë në vit, me qëllim monitorimin e zbatimit të Projektit, si dhe për të rënë dakord mbi ndryshimet e mundshme.

Pezullimi i kontributeve dhe përfundimi i Marrëveshjes

GIZ-i mund të pezullojë kontributet e tij nëse:

- MFE-ja nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga kjo Marrëveshje ose nga marrëveshjet që lidhen me këtë Marrëveshje, ose
- linden rrethana që pengojnë ose vënë në rrezik të konsiderueshëm objektivin e Projektit të përshkruar në Klauzolën 1 më lart.

Nëse lind një nga rrethanat e përshkruara në fjalinë 1 më lart dhe nëse ekziston ende pas një afati kohor kohor të dakordësuar nga GIZ-i me MFE-në, ose nëse nuk eliminohet brenda kësaj periudhe, GIZ-i, me miratimin e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, mund të mbyllë zbatimin e kësaj Marrëveshje para afatit.

Afati i Marrëveshjes

Përveç kur parashikohet në Klauzolën 4 më lart në lidhje me pezullimin e kontributeve dhe përmbylljen e Marrëveshjes, kjo Marrëveshje do të jetë në fuqi për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit deri më 30 Nëntor 2020. Afati i kësaj Marrëveshjeje mund të zgjatet, në rast të një vonese të ekzekutimit të kontributit gjerman, siç parashtrohet në këtë Marrëveshje dhe të ekzekutimit të kontributeve të dakordësuar të MFE-së. Zgjerimi i termave të kësaj marrëveshje duhet të bëhet me shkrim dhe të nënshkruhet nga të dyja palët.

Amendimet e Marrëveshjes

Në rast se dispozitat e kësaj marrëveshje nuk ndihmojnë për arritjen efikase të objektivit të përcaktuar në Klauzolën 1 më lart, atëherë GIZ dhe MFE mund t'i përshtatin ose amendojnë këto dispozita me pëlqim të përbashkët në çdo fazë gjatë zbatimit të Projektit. Çdo amendim duhet të bëhet me shkrim.

GIZ-i mund ta përfundojë këtë Marrëveshje në mënyrë të njëanshme nëse detyra me të cilën është ngarkuar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë tërhiqet/anulohet.

Mosmarrëveshjet

Mosmarrëveshjet rreth interpretimit dhe zbatimit të kësaj marrëveshje do të zgjidhen nga GIZ dhe MFE. Në rast se brenda një afati prej tre muajsh, nuk do të mund të gjejnë një zgjidhje të pranuar nga të dyja palët, mosmarrëveshjet do të zgjidhen përmes bisedimeve nëpërmjet kanaleve diplomatike mes dy qeverive, deri në fund të muajit pasardhës.

Forma me shkrim

Amendimet dhe shtesat në këtë Marrëveshje, dhe çdo deklaratë tjetër e rëndësishme apo komunikime të një rëndësie për zbatimin e kësaj Marrëveshje, do të bëhen më shkrim. Në rastin e deklaratave dhe komunikimeve për GIZ-in, është e mjaftueshme që të merren nga drejtuesi i ekipit të ekspertëve të vënë në dispozicion.

Marrëveshjet me organizata zbatuese të veçanta

Personi përgjegjës për kontributin nga GIZ dhe personi/personat përgjegjës për kontributet nga organizata partnere ose nga organizata të tjera zbatuese, mund të lidhin bashkërisht një

marrëveshje detyruese për detajet shtesë që lidhen me zbatimin e Projektit (p.sh. në bazë të planit të veprimeve), ose në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme t'i shënojnë ato detaje me shkrim dhe, kur është e nevojshme, ta përshtatin një marrëveshje të tillë duke marrë në konsideratë zhvillimet në Projekt.

Marrëveshjet Qeveritare

Për sa i përket pjesës tjetër, dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunim Teknik (shihni Shtojcën 1) dhe Procesverbalit të Bisedimeve për Bashkëpunimin për Zhvillim ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të mbajtura në Tiranë në datën 12 korrik 2016, Shtojca 2), të cilave ju referohemi në fillim të kësaj Marrëveshje, do të zbatohen edhe për këtë Marrëveshje.

Hyrja në fuqi, kopjet

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi, pas përfundimit të procedurave të brendshme ligjore, të parashikuara nga ligji nr.43/2016 "Për lidhjen e marrëveshjeve nderkombetare ne Republiken e Shqiperise".

Marrëveshja hartohet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze dhe të dy tekstet janë autentike me fuqi të barabartë.

Në emër të Republikës së Shqipërisë

Arben Ahmetaj

Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Në emër të Agjencisë Gjermane për
Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ)

Hans-Jürgen Cassens

Drejtori për Shqipërinë

Koordinatori Kombëtar për PME-në

Florenc Qosja